

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6963
E martë, 8 gusht 2023
Çmimi 0.40

Policia e Prishtinës
shqiptoi mbi 14 mijë
gjoba për kundërvajtje në
trafik gjatë korrikut | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIGJVËNËSIT EVROPIANË DHE AMERIKANË KËRKOJNË NDRYSHIM TË QASJES NDAJ KOSOVËS DHE SERBISË | FAQE 4-5



Deputetja e parlamentit britanik Alicia Kearns publikoi një letër në të cilët theksohet se dhjetëra politikanë nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u janë drejtuar zyrtarëve të lartë të

Bashkimit Evropian dhe Uashingtonit dhe kërkojnë që të ndryshohet qasja e tyre në raport me Kosovën dhe Serbinë. Aty përmenden tensionet në muajt e fundit në veriun e Kosovës i

banuar me shumicë serbe dhe përmes letrës, nga Bashkimi Evropian dhe Uashingtoni, kërkohet "balancë dhe proporcionalitet në bashkëveprim me Kosovën dhe Serbinë"


**AVOKATJA
E KRASNIQIT
KËRKON QË
AI TË LIROHET
PËR DY JAVË**

| FAQE 6



**NË GJASHTË
MUAJT E
PARË TË
VITIT NË
KOSOVË JANË
PËRDHUNUAR
53 VAJZA
DHE GRA**

| FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**85 INFERMIERË TË RINJ
FILLOJNË PUNËN NË KLINIKAT
E QKUK-së** | F. 3

**KËSHILLTARJA E KRYEMINISTRIT
KURTI NDALOHET NË KUFİ NGA
POLICIA SERBE** | F. 5

**DËNOHET GJASHTË MUAJ BURGIM
MËRGIMTARI QË KANOSI
DEPUTETEN GANIMETE MUSLIU** | F. 7

EKONOMI



**HAPET THIRRJA, QYTETARËT
DO TË SUBVENCIONOHEN PËR
INVESTIMET EFIÇIENTE NË SHTËPI**

| F. 7

**FËMIJËT QË LYPIN PARA NË
RRUGË: TË ABUZUAR NGA
PRINDËRIT, TË SHTYRË
NGA VARFËRIA** | F. 8

SPORT



**SOT SHORTI I PARAKUALIFIKIMEVE
PËR KUPËN E BOTËS 2027, KOSOVA
NË VAZON E DYTË** | F. 10

Shkon në gjashtë numri i të vdekurve nga vërshimet në Slloveni

LUBJANË, 7 GUSHT - Numri i përgjithshëm i të vdekurve nga shirat e mëdha dhe vërshimet në Slloveni është rritur në gjashtë, raportuan mediet lokale të hënën.

Kryeministri i Sllovenisë, Robert Golob, i ka përshkruar shirat rrëshkë dhe vërshimet e mëdha - të cilat e goditën vendin e Alpeve me dy milionë banorë - si fatkeqësinë më të madhe natyrore që nga shpallja e pavarësisë tri dekada më parë.

Shirat dhe rrëshqitjet e dheut, që nisën të enjten, kanë përmblytur pjesë të mëdha të Sllovenisë qendrore dhe veriore, duke e bllokuar qasjen në fshatra dhe

duke e penguar trafikun.

Të dielën ekipet emergjente e nxorën trupin e një burri 35-vjeçar nga një lumë afër fshatit Mirna Perc në lindje të vendit. Një burrë tjetër, i cili po merrte pjesë në operacionet e pastrimit, u gjet i vdekur pasi kishte rënë në një gropë uji pranë qytetit Kamnik, afër Lubjanës, raportuan mediet lokale.

Trupat e dy sllovenëve dhe dy qytetarëve holandezë u gjetën më herët.

Të hënën punëtorët e shpëtimit u përpoqën t'i hapnin rrugët në vendet e thella dhe të izoluara, derisa edhe i vlerësuan dëmet, për të cilat qeveria e vendit ka

thënë se mund ta tejkalojnë shifrën e 500 milionë eurove.

Sllovenia, anëtare e Bashkimit Evropian (BE), i ka kërkuar ndihmë bllokut, në veçanti makineri të rënda, si ekskavatorë dhe ura të përkohshme të parafabrikuara, për t'u përballur me pasojat e vërshimeve. Ajo i ka kërkuar edhe NATO-s t'i ofrojë helikopterë dhe ushtarë.

Kamioni i parë me ndihma humanitare dhe ushqim mbërriti nga Hungaria të dielën në mbrëmje. Kroacia ia ofroi një helikopter ushtarak për ta ndihmuar ta mbyllë dhe sigurojë një argjinaturë në lumin Mura. Kancelari gjerman Olaf Scholz ka



thënë se vendi i tij do të dërgojë punëtorë emergjentë si dhe u shpreh i "tronditur" me "katastrofën e tmerrshme të vërshimeve në Slloveni dhe Austri".

Avokatët e Trumpit do ta kundërshtojnë kufizimin e ndarjes së informacioneve

WASHINGTON, 7 GUSHT - Ekipi ligjor i ish-presidentit Donald Trump thotë se do t'i kundërshtojë kërkesat e prokurorëve federalë për të kufizuar atë që ata mund ta ndajnë me publikun lidhur me padinë e fundit ndaj Trumpit.

Duket se rasti po vjen duke u vështirësuar, ndërsa reagimet globale mbi sfidat ligjore të Trumpit janë të ngadalta.

Ish-presidenti Donald Trump, i cili po rikandidon për këtë pozitë, e quajti "sajesë" padinë e fundit kundër tij gjatë një tubimi me mbështetësit në Kolumbia të Karolinës së Jugut.

Javën e kaluar ai u paraqit në gjykatë për akuzat për komplot për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të 2020-s që ai i humbi.

Prokuroria do ta ketë të vështirë ta provojë këtë, tha avokati i Trumpit, John Lauro, në emisionin "This Week" të rrjetit ABC. "Ata kurrë nuk do të jenë në gjendje të vërtetojnë nëse ai po vepron në mënyrë të pandershme, nëse po kryente një krim" me vetëdije, tha ai.

Pas një postimi të Trumpit në internet, i cili dukej si një kërcënim për hakmarrje ndaj



kujt do që shkon pas tij, prokurorët i kërkuar një gjyqtari federal, që ta kufizonte informacionin që ai dhe ekipi i tij mund të ndajnë me publikun për këtë rast.

Ekipi ligjor ka afat të përgjigjet deri të hënën. Avokati John Lauro komentoi këtë çështje në CNN. "Shtypi dhe populli amerikan në një kohë fushate kanë të drejtë të dinë se cilat janë

provat në këtë rast. Meqenëse provat nuk mund të mbrohen ndryshe, ne do ta kundërshtojmë atë", tha avokati i ish-presidentit Trump.

Ish-nënpresidenti Mike Pence, një nga kandidatët për president në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, mund të thirret për të dëshmuar në gjykatë.

Ai shpjegoi në CNN pse refuzoi kërkesat e avokatëve të Trumpit

për t'i përmbysur zgjedhjet e vitit 2020. "Asnjë nënpresident, ose dikush tjetër, nuk duhet të ketë kurrë të drejtën ta përcaktojë presidentin amerikan. Presidenca i përket popullit amerikan dhe vetëm popullit amerikan", tha ai.

Reagimet globale ndaj sfidave ligjore të Trumpit kanë qenë të ngadalta.

Profesori i shkencave politike në

Universitetin e Uashingtonit, James Long, thotë se nuk është i befasuar. "Disa udhëheqës në disa vende të veçanta kanë marrë mesazhin e gabuar nga sjellja e Trumpit. Tani për tani ata ndoshta po tregohen të zgjuar, duke qëndruar në heshtje dhe në pritje të asaj që do të ndodhë, ndërsa vazhdojnë të përpiqen të kenë marrëdhënie të mira diplomatike me Shtetet e Bashkuara", thotë ai.

Edhe pse njerëzit jashtë Shteteve të Bashkuar mund të jenë lodhur duke dëgjuar për këtë çështje, ose mendojnë se ky nuk është një problem që i prek ata, aktakuza e fundit ndaj Trumpit duhet të merret seriozisht, thotë Kathryn Sikkink, eksperte e marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Harvad. "Nëse nuk keni demokraci ose demokracia është e dobët, të drejtat e njeriut rrezikohen. Unë besoj se në periudhën afatgjatë, nëse kjo çështje trajtohet mirë në Shtetet e Bashkuara, vendet e tjera do t'i kushtojnë vëmendje", thotë ajo. Sipas saj, kjo çështje mund të shërbejë si një shembull se si Shtetet e Bashkuara janë në gjendje t'i kapërcejnë problemet e brendshme përmes ligjit.

Mbi 20 të burgosur ukrainas lirohen nga Rusia

KIEV, 7 GUSHT - Kreu i zyrës presidenciale ukrainase, Andriy Yermak, njoftoi përmes "Telegrami"-t se 22 të burgosur të luftës janë kthyer në Ukrainë nga burgjet ruse më 7 gusht.

Në mesin e të liruarve janë dy oficerë, ushtarë të thjeshtë dhe nënoficerë. Ata kishin

marrë pjesë në betejat në fronte të ndryshme dhe disa prej tyre ishin plagosur, tha Yermak. Ai nuk dha më shumë detaje.

Ministria ruse e Mbrojtjes ende nuk ka komentuar për këmbimin e të burgosurve. Këmbimi i fundit i të burgosurve në mes të Rusisë

dhe Ukrainës ka ndodhur në korrik të këtij viti.

Rusia ka nisur pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurtin e vitit 2022. Lufta ka lënë të vvarë mijëra persona, ka detyruar të zhvendosen miliona të tjerë dhe ka shkaktuar dëme të mëdha materiale.



Aksion kundër drogës në Mitrovicë të Veriut

MITROVICË, 7 GUSHT - Policia e Kosovës ka kryer një aksion kundër drogës në një banesë në lagjen "Tre Rrokaqiejt" në Mitrovicë të Veriut. Zëvendësrejtori rajonal për veriun, Veton Elshani, tha se gjatë aksionit janë konfiskuar edhe armë. "Banesa është shfrytëzuar nga S. M. [shtetas i Kosovës i nacionalitetit serb], janë gjetur dhe konfiskuar 60 kartela grafike, makina anti-miner S9, 13 ventilatorë, poqa elektrikë që

shfrytëzohen për rritjen e bimëve të kanabisit, llambë elektrike për laborator, 51 fishekë, tetë shok-bomba të modifikuara", tha Elshani për Radion Evropa e Lirë. Ekipit të REL-it nuk i është lejuar t'i afrohet ndërtesës ku po kryet aksioni. Gazetarëve të REL-it u është thënë se bëhet fjalë për një banesë private. Kjo nuk është hera e parë që Policia e Kosovës kryen aksione kundër drogës, apo

kundër kriptovalutave në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe. Në shkurt të këtij viti policia zbuloi tre laboratorë droge në Mitrovicë të Veriut. Po ashtu, në maj të vitit të kaluar policia kishte shkatërruar dy laboratorë droge në Izvor, afër kufirit me Serbinë, ku ishin gjetur edhe sasi të mëdha të bimëve narkotike të llojit marijuanë. Në prill të atij viti ishte shkatërruar një laborator droge



në Zvečan dhe ishin arrestuar katër serbë. Autoritetet e rendit gjithashtu

kanë kryer disa aksione në Kosovë, përfshirë në veri kundër mihjes së kriptovalutave.

Avokatja e Krasniqit kërkon që ai të lirohet për dy javë

HAGË, 7 GUSHT - Venkateswari Alagendra, avokatja e ish-kryeparlamentarit Jakup Krasniqi, ka kërkuar që klienti i saj të lirohet përkohësisht për të kaluar pak kohë me familjen e tij në Kosovë.

Duke marrë parasysh pushimet e verës në Gjykatën Speciale në Hagë, avokatja e Krasniqit ka kërkuar që ai të lirohet për dy javë. Mbrojtja në kërkesën e saj thekson se Krasniqi ndodhet në paraburgim që dy vjet e tetë muaj, duke kërkuar që ai të lirohet nën mbikëqyrje.

Avokatja e Krasniqit pretendon se paraburgimi i tij s'është i domosdoshëm, pasi s'ka rrezik për t'u arratisur dhe për të penguar në procedurat gjyqësore. "Deklaratat publike të z. Krasniqi janë ushtrim i fjalës së lirë dhe jo të mjaftueshme për të treguar një prirje ndaj ndërhyrjes në dëshmitarë", thuhet në parashtresën e avokates Alagendra.

Ajo shton se s'ka arsye të mjaftueshme për ta arsyetuar moslirimin e Krasniqit dhe se s'ka asnjë provë konkrete se ndonjë dëshmitar është frikësuar nga Krasniqi, raporton "Express". "Mungesa e ndonjë prove faktike që z. Krasniqi ka qenë i përfshirë në ndonjë kërcënim të dëshmitarit në këtë procedurë vë në pikëpyetje nevojën për paraburgim të vazhdueshëm", thuhet në parashtresë.

Së dyti, mbrojtja thekson se "vetëdija e z. Krasniqi për ecurinë e rastit gjatë katër muajve të fundit, në fakt, zvogëlon gjasat që ai të përfshihet në ndonjë aktivitet të ndaluar". "Prokuroria ka thirrur deri tani 11 dëshmitarët e saj të parë. Askush nuk ka folur keq për z. Krasniqi. [REDAKTUAR]. Provat që Paneli



ka dëgjuar nuk e mbështetin atë karakterizimin e z. Krasniqi si person që ka gjasë të ndërhyjë në dëshmitarë ose të kryejë krim të mëtejshëm. Për më tepër, është e vështirë të kuptohet se çfarë imagjinon Prokuroria se do të ishte motivimi i z. Krasniqi për t'i frikësuar dëshmitarët e mbrojtur

të viktimave në këtë rast - shumica dërrmuese e të cilëve, siç do të ketë vërejtur Trupi Gjyqësor, nuk e përmendin fare z. Krasniqi ose të thonë thjesht se e dinin se ai ishte ai zëdhënës i UÇK-së", thuhet në parashtresë. Së treti, avokatja thekson se "Paneli tani ka një përvojë të vëzhguar të

paraburgimit dhe gjykimit të zgjatur për z. Krasniqi". "Në moshën 72-vjeçare ai është dukshëm më i vjetër se të akuzuarit e tjerë në këtë rast", shkruan avokatja Alagendra. Aty janë ofruar edhe disa kushte, si lirim për dy javë i Krasniqit, vendi ku do të banonte, kontaktet e

kufizuara dhe kush do të banonte me të.

Në alternativë, Mbrojtja kërkon që, nëse lirim i përkohshëm refuzohet, Krasniqi t'i lejohen "vizita shtesë private në Njësinë e Paraburgimit gjatë pushimeve verore", për të pasur kohë shtesë për të kaluar me familjen.

85 infermierë të rinj fillojnë punën në klinikat e QKUK-së

PRISHINË, 7 GUSHT - 85 infermierë të rinj do të fillojnë të martën punën në klinikat të ndryshme të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Punësimi i tyre do ta zbusë pjesërisht mungesën e

infermierëve në klinikat e QKUK-së. Nënshkrimi i kontratave u bë të hënën. Me këtë rast, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, infermierëve u dëshiroi punë të mbarë, duke i porositur

ata që në qendër të punës së tyre të kenë kujdesin ndaj pacientëve. Nga 85 infermierët e pranuar së fundmi, 70 janë me kualifikim bachelor dhe 15 me shkollim të mesëm.





Ligjvënësit evropianë dhe amerikanë kërkojnë ndryshim të qasjes ndaj Kosovës dhe Serbisë

Deputetja e parlamentit britanik Alicia Kearns publikoi një letër në të cilët theksohet se dhjetëra politikanë nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u janë drejtuar zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian dhe Uashingtonit dhe kërkojnë që të ndryshohet qasja e tyre në raport me Kosovën dhe Serbinë. Aty përmenden tensionet në muajt e fundit në veriun e Kosovës i banuar me shumicë serbe dhe përmes letrës, nga Bashkimi Evropian dhe Uashingtoni, kërkohet “balancë dhe proporcionalitet në bashkëveprim me Kosovën dhe Serbinë”

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 GUSHT - Dhjetëra politikanë nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara u kanë dërguar një letër zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian dhe Uashingtonit, duke kërkuar të ndryshohet qasja në raport me Kosovën dhe Serbinë. Deputetja britanike Alicia Kearns publikoi letrën që i është dërguar sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, shefit të diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, dhe sekretarit të Jashtëm britanik, James Cleverly. Ajo tha se kjo letër është nënshkruar nga dhjetë kryetarë të komiteteve për punë të jashtme dhe 56

deputetë. Në mesin e nënshkruesve të kësaj letrë janë edhe senatori amerikan Bob Menendez dhe kongresisti Ritchie Torres. Duke adresuar tensionet e fundit në veri të Kosovës, përmes letrës u kërkua “balancë dhe proporcionalitet në bashkëveprimin me Kosovën dhe Serbinë”. Tensionet në veri të Kosovës u rritën në fund të majit, pasi kryetarët e rinj të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, nën përcjelljen e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale. Serbët lokalë kundërshtuan këtë gjë dhe organizuan protesta, të cilat kulmuan me dhunë më 29

maj në Zveçan, me ç’rast u lënduan dhjetëra protestues dhe ushtarë të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. “Kosova është përballur me pasoja të mëdha pas përpjekjeve të kryetarëve që të hyjnë në zyrat e tyre në veri të Kosovës. Kosova duhet të koordinohet me KFOR-in në të ardhmen për t’i parandaluar përkallëzimet. Por, mungesa e presionit ndaj Serbisë pas ndalimit arbitrar të tre policëve të Kosovës dhe dështimi për t’i mbajtur përgjegjës ata që kryen sulme ndaj KFOR-it vënë në pah mungesën e barazisë në adresimin e tensioneve”, u tha në letër. Në kohën e tensioneve në rritje,

tre policë të Kosovës u arrestuan nga forcat serbe më 14 qershor. Kosova tha se ata u “rrembyen” brenda territorit të saj, por Serbia tha se i arrestoi “thellë brenda” territorit serb. Policët u liruan më 26 qershor. “Qasja aktuale nuk po funksionon. Ne kërkojmë nga komuniteti ndërkombëtar që të mësojë nga e kaluara jonë dhe të sigurohemi që ne nuk do të miratojmë politika për Ballkanin që anojnë nga Beogradi. Ne, po ashtu, u kërkojmë ta shqyrtoni mundësinë e miratimit të një politike të diplomacisë parandaluese për ta shmangur përkallëzimin e mëtejshëm të situatës së sigurisë dhe asaj politike në veri të Kosovës, me balancë dhe proporcionalitet në çdo deklaratë dhe çdo ndëshkim apo sanksion që ndërmerret, dhe që ata të cilët respektojnë sundimin e ligjit dhe demokracinë, të mos ndëshkohen”, u tha në letër. Për shkak të mospërbushjes së kërkesave kryesore të faktorit ndërkombëtar për uljen e tensioneve në veri, BE-ja ka

vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Megjithatë, Kosova është pajtuar me BE-në në një plan për shtensionimin e situatës, që parasheh edhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri të Kosovës. Prishtina ka thënë se zgjedhjet në veri duhet të përgatiten, që të mos ketë bojkot sërish sikurse në zgjedhjet e 23 prillit. Në këto zgjedhje serbët lokalë dhe partitë e serbëve në Kosovë nuk morën pjesë. Sa iu përket zgjedhjeve, në letër u tha se Kosova është shtet i pavarur dhe “përpjekjet për t’i penguar zgjedhjet demokratike në Kosovë nga Serbia duhet të kritikohen publikisht si ndërhyrje nga jashtë”. Si pjesë e planit në mes të Kosovës dhe BE-së javën e kaluar është ulur më tej prania e policisë në afërsi të komunave në veri të Kosovës që janë të banuara me shumicë serbe. Ndërkohë Qeveria e Kosovës ka nisur punën për sigurimin e bazës ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të reja të parakohshme në katër komunat


Ministrja Haxhiu: Mërgata, mbështetja e madhe e Kosovës

Prishtinë, 7 gusht - “Me punë të palodhshme, me sytë nga Kosova, me dëshirën e zjarrtë për t’i kontribuar familjes, shtetit dhe shoqërisë, mërgata aktivisht vepron duke

ndihmuar në zhvillimin e vendit tonë”, ka thënë ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, gjatë një takimi me bashkatdhetarët. Ajo ka thënë se është përherë

kënaqësi të ndash momente bashkë me ta, të diskutosh për pyetjet që shtrojnë e të pyesësh për punët që ata bëjnë. “Është frymëzues fakti që në mërgatë po rritet edhe

një brez tjetër, të rinj të arsimuar e të profesionalizuar me dëshirën që dijen e tyre ta sjellin në Kosovë. Përherë mirënjohës dhe falënderues”, ka thënë ministrja Haxhiu.



Këshilltarja e kryeministrit Kurti ndalohehet në kufi nga policia serbe

PRISHTINË, 7 GUSHT - Këshilltarja politike e kryeministrit të Kosovës për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, Ardita Sinani, ka thënë se u ndalua për "mbi një orë" nga policia serbe në kufi me Kosovën të hënën. Sinani tha se policët kufitarë serbë e ndaluan më 7 gusht në

pikëkalimin Muçibabë, rreth 20 kilometra larg Gjilanit, në juglindje të vendit. "Arsyetimi i vetëm që m'u dha nga policët kufitarë të Serbisë: 'Kemi urdhër për ndalimin tuaj dhe nuk mund t'ju lejojmë ta kaloni kufirin pa marrë pëlqim nga baza'", ka shkruar Sinani në "Facebook".

Presheva, Medvegja dhe Bujanoci janë tri komuna me shumicë shqiptare në jug të Serbisë.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e Serbisë nuk ishte e qasshme për koment rreth këtij rasti. Ish-kryetarja e komunës së Preshevës u ankua se u ndalua pa

"asnjë sqarim shtesë për arsyen, apo se kush është baza që duhet pyetur dhe marrë leje për ta kaluar kufirin". "Kjo, mbase, mund të jetë kostoja e të qenit këshilltare politike e kryeministrit të Republikës së Kosovës, por sigurisht nuk do të jetë mjeti me të cilin do të

heshtet zëri për të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës", ka shkruar ajo. Ky rast, nënvizoi ajo, sigurisht se do të jetë vetëm "shtytje edhe më e madhe për të folur me zë edhe më të lartë" për diskriminimin shtetëror serb ndaj shqiptarëve.



në veri të Kosovës, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Veri të Mitrovicës.

Në këtë mënyrë, sipas ministrit të pushtetit lokal, Elbert Krasniqi, grupi punues ka një muaj kohë për të hartuar një dokument që do t'u mundësonte qytetarëve të komunave në veri shkarkimin e kryetarëve aktualë përmes një peticioni të qytetarëve të regjistruar me të drejtë vote në komunat përkatëse.

Hapat drejt shtensionimit të situatës në veri të Kosovës

Marrëveshja ndërmjet BE-së dhe Kosovës për zbatimin e deklaratës së 3 qershorit 2023 të 27 vendeve të BE-së

1. Qeveria e Kosovës deklaroi publikisht gatishmërinë e saj për t'u angazhuar për shtensionimin e situatës dhe se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim që mund të shkallëzojë situatën në veriun e Kosovës. Kjo përfshin një zvogëlim të menjëhershëm

për 25% të pranisë policore në dhe rreth ndërtesave komunale.

2. Policia e Kosovës kryen vlerësime të rregullta të sigurisë bashkë me EULEX-in, dhe me KFOR-in, sipas nevojës, për të shikuar mundësinë për zvogëlim të mëtejshëm të tërë pranisë policore në dhe rreth ndërtesave komunale.

3. Qeveria e Kosovës bën një deklaratë publike, për të mbështetur mbajtjen e zgjed-

hjeve të parakohshme në 4 komunat veriore, pas verës. Kosova përkushtohet të sigurojë bazën e nevojshme ligjore për të mundësuar organizimin e zgjedhjeve.


4. BE-ja do t'i ftojë dy kryenegociatorët në Bruksel, për finalizimin e planit të sekuencimit për Marrëveshjen drejt rrugës për normalizimin e marrëdhënieve, pas të cilit do të fillojë zbatimi i të gjitha neneve të marrëveshjes.

Në gjashtë muajt e parë të vitit në Kosovë janë përdhunuar 53 vajza dhe gra

Prishtinë, 7 gusht - "Në gjashtë muajt e parë të vitit në Kosovë janë përdhunuar 53 vajza dhe gra. 53 të përdhunara, qindra të tjera të ngacmuara e sulmuara seksualisht, e mijëra nga ne të cilat jetojmë çdo ditë si të ishte luftë. Për shumë nga ne përditshmëria është e shoqëruar me frikë. Për shumë nga ne çdo ditë është luftë", është bërë me dije në njoftimin e Kolektivit për Mendim dhe

Veprim Feminist. Megjithatë, në njoftim theksohet se kjo frikë nuk duhet të përdoret si mjet "për të na disiplinuar neve, për të na bërë më të kujdesshme a vigjilente në mos hasim në dhunues e shoqërinë indiferente ndaj problemit". Sipas Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist, "kjo gjendje dhune është duke e qeverisur shoqërinë tonë, andaj duhet t'i kundërvihemi me

organizim". "Nga rrugët e Prishtinës ne thërrasim në mobilizim dhe angazhim mbarëshoqëror në zhbërjen e strukturave patriarkale që po prodhojnë dhunë, burra përdhunues e një shoqëri apatike. Thërrasim në revoltë kolektive dhe solidarizim me të gjitha/ë të mbijetuarave/ëve të dhunës", është theksuar në njoftimin e Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist.



Bulliqi paralajmëron gjoba të ashpra për ata që hedhin mbeturina në lumin e Llapit

PODUJEVË, 7 GUSHT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se kanë filluar pastrimin e lumit Llap nga mbeturinat,

të cilat po grumbullohen rreth shtratit nga persona të papërgjegjshëm. “U bëj apel të gjithë qytetarëve të mos hedhin mbeturina në lumenj,

përndryshe gjobat nga ana e Drejtorisë së Inspeksionit do të jenë të ashpra. I ftoj edhe qytetarët që në rast se shohin dukuri të tilla të hedhjes së

mbeturinave nga kushdo t'i lajmërojnë rastet në Drejtorinë e Inspeksionit!”, ka shkruar Bulliqi në “Facebook”.



Hamza nënshkruan marrëveshjet për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e turizmit

MITROVICË, 7 GUSHT - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga drejtori Elvis Feka, ka nënshkruar marrëveshjet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të thirrjes së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Me këtë rast, kryetari Hamza i ka përgëzuar përfituesit e subvencioneve publike, duke ofruar gjithë bashkëpunimin në

funkcion të realizimit të projekteve në fushën e turizmit. Ndërsa drejtori Feka ka thënë se drejtoria që drejton po subvencionon 10 organizata joqeveritare të cilat do të realizojnë projekte për promovimin e pikave turistike, shenjëzimin e shtigjeve të ecjes, realizimin e instalacioneve turistike, kullave informuese për turistët si dhe promovimin e turizmit industrial në Mitrovicë.



Kryetari i Prishtinës: Shtatori do t'i gjejë nxënësit me ambiente të reja shkollore



Prishtinë, 7 gusht - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se janë duke vazhduar punimet me ritëm të lartë për renovimin e ShFMU “Naim Frashëri”. Ai ka thënë se paralelisht me këtë shkollë renovimet janë duke

vazhduar edhe në shkolla dhe institucione të tjera arsimore. “Jemi duke ndërtuar me ritme të shpejta katër shkolla, anekse dhe tri kopshte të reja. Në këtë mënyrë ne po rritim mjediset dhe hapësirat komode për nxënësit tanë. Jam shumë i

lumtur që me dinamikën e punëve që po bëjmë ne po realizojmë planprogramin për arsim. Shtatori që po vjen do t'i gjejë nxënësit me ambiente të reja e më të mira në shkollat e institucionet parashkollore të kryeqytetit”, ka thënë Rama.

Mbi 1 300 vizita specialistike janë kryer gjatë fundjavës në spitalin e Pejës

Pejë, 7 gusht - Në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë gjatë fundjavës janë kryer mbi 1 300 vizita specialistike. Në njoftimin e bërë për medie thuhet se gjatë fundjavës kanë pranuar 69 pacientë. “171 pacientë aktualisht janë të shtrirë, 544 pacientë kanë kryer 5 083 analiza”, thuhet në

njoftim. Të shtunën dhe të dielën kanë ndodhur edhe tetë lindje, 4 djem dhe 4 vajza. Po ashtu janë realizuar edhe 11 operime, 107 dializa, 217 rëntgene, 74 ultra zëra, 38 CT-ja, 6 rezonanca magnetike dhe 45 shërbime fiziatrike.



Gazetaret ukrainase përfundojnë me sukses nivelin B1 të kursit të gjuhës angleze

Prishtinë, 7 gusht - Gazetaret ukrainase përfundojnë me sukses nivelin B1 të kursit të gjuhës angleze, i cili u

mundësua nga JRS Kosovo. Kursi i gjuhës angleze dhe ai i gjuhës shqipe janë në kuadër të kurseve të integritetit të

refugjatëve në Kosovë. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka falënderuar organizatën si dhe ligjëruesen

e gjuhës angleze, Ardije Arifaj-Retkoceri, për korrektësinë dhe bashkëpunimin e treguar me koleget ukrainase.



Dënohet gjashtë muaj burgim mërgimtari që kanosi deputeten Ganimete Musliu

PRISHTINË, 7 GUSHT - Në Gjykatë Themelore në Prishtinë është shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit D. M., duke e dënuar me gjashtë muaj burgim, pasi e kishte pranuar fajësinë se ka kanosur deputeten e Kuvendit të Kosovës, Ganimete Musliu. Dënimi me burgim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Gjykatësi Driton Berisha deklaroi se dënimi me burgim ndaj D. M mund të zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 5 000.00 eurosh me pëlqim të të akuzuarit.

Gjithashtu, i akuzuari obligohet që të paguajë edhe shpenzimet procedurale aq sa do të llogariten nga gjykata, si dhe shumën prej 20 eurosh në emër të paushallit gjyqësor dhe 20 euro të tjera për fondin e kompensimit të viktimave të krimit.

Sipas aktakuzës së përpiluar më 18 maj 2023, më 23 dhjetor 2022 rreth orës 17:16, derisa e dëmtuara Ganimete Musliu ishte në veturën e saj në lagjen e

“Spitalit” në Prishtinë, i akuzuari Driton Maloku përmes telefonit mobil e kanos të dëmtuarën Ganimete Musliu në cilësinë e deputetes së Kuvendit të Kosovës me fjalët: “A je ti Ganimetja? Ty duhet me të zhdrukë”. E pas disa minutash, rreth orës 17:35, i dërgon një mesazh përmes telefonit mobil me tekstin “Përshëndetje Ganimete. A je tu ma krye qatë punë me shti qatë personin në punë për çka je paguar, a po i kthen ato 20,000.00 euro qe mi ke marrë për me krye punë”. Këto mesazhe tek e dëmtuara Ganimete Musliu kanë shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetën dhe trupin e saj.

Deputetja Musliu përmes një postimi në “Facebook” ka shkruar se ky person që e kanosi nga Zvicra “të premten në seancë tha se ‘nuk voton në Kosovë prej 20 vitesh’ dhe pranimin e fajësisë e bëri krejt formlisht e në mënyrë të pasinqertë. Por, në një pikë ai ishte shumë i sinqertë. Deklaroi se ‘kishte rënë në ndikimin e propagandës së Lëvizjes



Vetëvendosje”, ka shkruar Musliu.

Ajo ka thënë se ky është një shembull konkret se gjuha me të cilën partia - shtet i ushqen militantët e saj, është gjuhë e

urrejtjes, përçarjes dhe mosdurimit. “Dhe, si e tillë, jo vetëm e papranueshme, por edhe e dënueshme. Përndryshe, konsideroj se dënimi ndaj personit që më kanosi është

shumë i ulët dhe do të konsultohem me avokatin tim për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta kundërshtuar me ankesë”, ka shkruar deputetja Musliu.

Policia e Prishtinës shqiptoi mbi 14 mijë gjoba për kundërvajtje në trafik gjatë korrikut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 GUSHT - Policia e rajonit të Prishtinës, duke u mbështetur në vlerësimet e fundit që i ka bërë situatës së sigurisë në trafikun rrugor, ka shtuar dinamikën e veprimeve dhe masave të ndërmarrura me qëllim të përmirësimit të treguesve të sigurisë rrugore dhe uljes së numrit të kundërvajtjeve në trafik. “Me gjithë faktin se policia në vazhdimësi është angazhuar në kontrollin për zbatimin e rregullave të trafikut nga të gjithë shfrytëzuesit e rrugës duke synuar uljen e numrit të kundërvajtjeve në trafik dhe ngjarjeve aksidentale, është parë e nevojshme që, krahas kontrolleve të strukturave të policisë, të punohet edhe në drejtim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Mbështetur mbi këtë bazë, në kuadër të shtimit të punës preventive për forcimin e



rregullit si dhe disiplinimin e shfrytëzuesve të rrugës, vetëm për muajin korrik policia e rajonit të Prishtinës ka shqiptuar 14 009 masa administrative për kundërvajtje të ndryshme në

trafikun rrugor, me theks të veçantë: tejkalim i shpejtësisë, 4 082 gjoba; parking i parregullt, 3 019 gjoba; përdorimi i telefonit gjatë ngasjes, 1 172 gjoba; mospërdorimi i rripit të sigurisë,

907 gjoba; drejtimi i mjetit pa patentë shofer, 321 gjoba; xhamat e errët, vendosja e foljes ose materialit tjetër, 285 gjoba; skadimi i afatit të regjistrimit të automjetit, 280 gjoba; tejkalim

në vijë të plotë, 48 gjoba; drejtimi i motoçikletës pa patentë shofer, 25 gjoba; motoçikleta të larguara nga komunikacioni, 18; drejtimi i motoçikletës pa regjistrim, 14 gjoba; drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit, 5 gjoba. Të tjera, 3 851.

Për kundërvajtjet më të rënda janë shqiptuar edhe 124 masa administrative, shqiptimi i masës mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik - marrja e përkohshme e patentëshoferit. 112 masa administrative, vazhdim i masës mbrojtëse. 72 masa administrative, shqiptimi i masave mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, marrja e përkohshme e patentëshoferit të huaj.

Policia e rajonit të Prishtinës ka njoftuar se do t'i vazhdojë aktivitetet me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor, ndërkaq i ka ftuar të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor që ta respektojnë sinjalistikën rrugore dhe ta shtojnë kujdesin.

Viti i ri shkollor 2023/24 fillon më 1 shtator

Prishtinë, 7 gusht - Zëdhënësja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Edona Kutleshi-Maliqaj, ka konfirmuar për “Telegrafi”-n

se procesi mësimor 2023/24 do të fillojë më 1 shtator (e premte). “Viti i ri shkollor do të nisë më 1 shtator dhe nuk do të ketë shtyrje. Së shpejti edhe ministrja do ta

nënshkruajë udhëzimin administrativ”, ka thënë ajo. Viti shkollor 2022/23 ishte përmbyllur në muajin qershor dhe është karakterizuar me protesta

dhe disa pakënaqësi nga ana e mësimdhënësve. SBASHK-u disa herë ka drejtuar ankesa për ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci.



Fëmijët që lypin para në rrugë: Të abuzuar nga prindërit, të shtyrë nga varfëria

PRISHTINË, 7 GUSHT - Aromën e qofteve dhe vajit të djegur në rrugët e shtruara me kalldrëm pranë shatërvanit në Prizren e shoqëron shpeshherë zëri i fëmijëve që kërkojnë para nga njerëzit e ulur nëpër restorantet e asaj zone turistike. Pavarësisht prej temperaturave të larta së fundi, disa fëmijë presin edhe pranë semaforëve për veturat që ndalen në pritje të dritës së gjelbër. Me shishet pa ambalazh e plot shukumë, ata tentojnë t'i bindin ngasësit t'u japin para në këmbim të pastrimit të xhamave. Por, këta fëmijë nuk janë kushdo...

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit mbi trafikimin e njerëzve në Kosovë, thuhet se cak i trafikuesve në vend janë veçanërisht fëmijët nga komunitetet e marginalizuara të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve. Këtë e ka konfirmuar edhe Ministria e Punëve të Brendshme, e cila drejton Autoritetin Kombëtar Kundër Trafikimit të Njerëzve.

Nora Fetoshi, zëdhënëse në këtë ministri, ka thënë për REL-in se fëmijët e këtyre komuniteteve "janë të cenueshëm ndaj lypjes së detyruar, por edhe trafikimit seksual". Megjithatë, zyrtari për komunikim në Institucionin e Avokatit të Popullit, Petrit Çollaku, thotë se pavarësisht që "fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë mund të jenë më të cenueshëm", një gjë e tillë nuk mund të vërtetohet "për shkak se pak dihet për numrin dhe profilin e vërtetë të fëmijëve në situatë rruge në Kosovë". "Mosidentifikimi i tyre dhe mungesa e të dhënave rreth tyre



i bënë ata 'të padukshëm' para ligjit dhe i privon ata nga gëzimi i të drejtave të garantuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale. Rrjedhimisht, situata e fëmijëve në situatë rruge në Kosovë përbën shkelje serioze të të drejtave të njeriut", thotë Çollaku.

Sipas statistikave të dhëna nga Policia e Kosovës, vetëm gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti janë identifikuar 41 fëmijë duke kërkuar lëmoshë. Por, Çollaku thekson se identifikimi i rasteve të tilla nuk është i lehtë. "Shumë prej tyre janë në lëvizje (migrimi i brendshëm ose ndërkufitar), si dhe disa nuk janë të regjistruar në regjistrat e lind-

jes ose nuk kanë formë të identifikimit personal", kanë thënë nga Avokati i Popullit.

Osman Osmani, i cili 22 vjetët e fundit të jetës së tij ia ka kushtuar luftës për ngritjen e cilësisë së jetës së fëmijëve nga këto komunitete, thotë se situata është përkeqësuar vitet e fundit. "Në vitet '80 apo '90 situata nuk ka qenë kështu. Ka pasur edhe atëherë varfëri, por ka pasur tepër rrallë familje që fëmijët e tyre i kanë shtyrë t'i bëjnë këto punë. Këto dukuri, fatkeqësisht, unë po i shoh këto dhjetë vjetët e fundit më të theksuara", thotë Osmani, kryesues i organizatës joqeveritare Nevo Koncepti, që punon për të drejtat e fëmijëve romë, egjiptianë dhe ashkalinj.

Pse këta fëmijë?

Në një qendër ditore për fëmijët në situatë rruge, të menaxhuar nga organizata Terre des Hommes në Prishtinë, rreth 250 fëmijë marrin shujta ushqimore çdo ditë. Rreth 90 për qind e fëmijëve në këtë qendër u takojnë komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali. Meqë është edhe vetë pjesëtar i komunitetit rom, Osmani thotë se ai është "me të vërtetë i

shqetësuar nga kjo gjendje". Sipas tij, faktorë kyç që kanë sjellë deri në këtë pikë janë varfëria dhe "diskriminimi shumë i gjatë në shoqëri".

Sipas Zyrës së OKB-së për Drogë dhe Krim, personat që vijnë nga "familje skajshmërisht të varfra, familje jofunksionale, apo pa përkujdesje familjare", mund të shfrytëzohen më së lehti për lypje në rrugë apo punë të detyruar.

Gjendja ekonomike në mesin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është përkeqësuar edhe më shumë nga pandemia Covid-19 në Kosovë, sipas një studimi të kryer nga organizata Foleja. Sipas studimit, vetëm rreth 12 për qind e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve përfituan nga ndihmat.

Riza Murati nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Policinë e Kosovës thotë se pikërisht kushtet e rënda ekonomike dhe sociale në familje janë arsyetimet që dëgjojnë më së shumti gjatë hetimit të këtyre rasteve. "Këta janë faktorët kryesorë që ata [fëmijët] janë në rrugë. Janë kryesisht fëmijë që nuk kanë përkujdesje të duhur nga ana e familjes së tyre, por edhe rrethi.

Braktisin shkollën dhe si rrugë e vetme u mbetet të dalin në rrugë", thotë Murati për REL-in. Për ta identifikuar profilin e fëmijëve në situatë të rrugës në Kosovë dhe identifikimin e arsyeve që i kanë shtyrë ata drejt kësaj situatë, Zyra në Kosovë e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) ka nisur Hulumtimin për Fëmijët në Situatë të Rrugës Shtetërore për përballimin e Covid-19, ndërsa "shumë persona humbën punën".

Të shtyrë nga varfëria, të dhënat tregojnë se në shumicën e rasteve janë vetë prindërit ata që shtynë fëmijët e tyre të dalin në rrugë për të kërkuar lëmoshë. "Prindërit duhet të kërkojnë ndihmë, mbështetje në institucione, dhe jo t'i përdorin fëmijët për t'i arritur qëllimet e tyre, për të kërkuar lëmoshë apo gjëra të tjera", thotë Murati, i cili shton se rreth 90 për qind të rasteve të hetuara kanë rezultuar se abuzuesit kanë qenë pikërisht familjarët e fëmijëve. Sipas Kodit Penal në Kosovë, "kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjet".

Numri i fëmijëve të identifikuar duke kërkuar lëmoshë

Vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti në Kosovë, 41 fëmijë janë identifikuar nga Policia e Kosovës duke kërkuar lëmoshë në rrugë. Nëse vazhdon ky ritëm, ky do të ishte numri më i lartë në vitet e fundit.

Hapet thirrja, qytetarët do të subvencionohen për investimet eficiente në shtëpi

Prishtinë, 7 gusht - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka bërë me dije se që nga nesër qytetarët mund të aplikojnë për subvencionim të termoizolimit të mureve të jashtme, termoizolimit të kulmeve, si dhe ndërrimit të dritareve dhe dyerve të jashtme për 45 % të vlerës së investimit, deri në 5 500.00 euro. "Tejet e lumtur që po lansojmë skemën e parë të

institucioneve të Republikës së Kosovës për eficientë e energjisë për sektorin rezidencial, e implementuar nga Fondi i Kosovës për Eficientë të Energjisë dhe e mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian në Kosovë. Faleminderit bordit dhe menaxhmentit të fondit, anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe të gjithë partnerëve të cilët kanë dhënë kontributin

e tyre", ka theksuar Rizvanolli, duke shtuar se ky projekt ka vlerë rreth 10 milionë euro.

Anëtarja e Bordit të Fondit të Kosovës për Eficientë të Energjisë, Nora Arifi, tha se nga ky projekt do të përfitojnë 2 000 familje. Ky projekt është mbështetur nga Bashkimi Evropian, me këtë rast u përshëndet nisja e tij nga përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë.



Shqiptari i cili u bë pesë herë kryeministër perandorie

Nga: Ardian MUHAJ

Koxha Sinan Pasha, apo Sinan Pashë Topojani, i biri i Ali Begut, është lindur në vitin 1506 në Topojan të Lumës dhe ka vdekur më 3 prill 1596. Ka qenë një nga kryeministrat më të rëndësishëm dhe që kanë lënë më shumë gjurmë në politikën e shtetit osman, por njëkohësisht edhe një nga burrështetasit me rëndësi botërore që ka lënë gjurmë të pashlyeshme dhe që ka ndikuar shumë edhe për historinë e trojeve shqiptare.

Është për t'u theksuar se Sinan Pasha ashtu si edhe shqiptarët e tjerë që kishin mbërritur majat më të larta të pushtetit në Ballkan dhe në Mesdhe, nuk jetonin të izoluar nga mjedisi shqiptar prej nga vinin, por përkundrazi, në një kontakt të vazhdueshëm e të pandarë me njerëzit e vendin e tyre. Madje është dëshmuar se këta shqiptarë që kishin marrë në dorë drejtimin e perandorisë më të madhe të kohës, anonin në zgjedhjet e tyre politike jo vetëm nga vendlindja, por edhe nga komshinjtë, siç është rasti i venedikasve. As madhështia e jetës së tyre në kryeqytetin e zhurmsëm të perandorisë, as atmosfera e ndryshme e jetës aty nuk ua dobësonte dashurinë dhe lidhjen me vendlindjen.

Studiues të ndryshëm kanë supozuar se Sinan Pasha kishte dalë nga radhët e fëmijëve të devshirmesë, por kjo hidhet poshtë nga dokumentacioni i bollshëm i kohës. Fakti që Sinan Pasha të atin e kishte mysliman dëshmon se ai nuk ishte kontingjent i devshirmesë. Nga faktet që argumentojnë qartazi se ai ishte edukuar në vendlindje, pranë gjirit të familjes, janë dokumentet e ambasadorëve venecianë në Stamboll, të cilët pohojnë me habi se Sinan Pasha edhe kur ishte bërë Kryeministër i shtetit osman e fliste me shumë vështirësi turqishten. Kjo është më se e kuptueshme edhe pse duket e habitshme.

Pikësëpari, Sinan Pasha ishte rritur e edukuar në Shqipëri dhe më pas karrierën e tij ushtarake përpara se të bëhej Kryeministër në dekadën e fundit të jetës, e kishte zhvilluar në flotën e Mesdheut, si kryeadmiral apo kapedan Pasha (Kapdeni derja) dhe si guvernator në provincat arabishtfolëse të shtetit osman, konkretisht në Egjipt, Jemen, Siri, Tunizi.

Sinan Pasha gjatë karrierës së tij të jashtëzakonshme ka mbajtur funksione të larta në shtetin osman. Në vitin 1569 u emërua guvernator i Egjiptit prej ku ndërmoi me shumë sukses



vendosjen e sundimit osman në Jemen. Pas Jemenit të cilin e mori dhe e inkuadroi në shtetin Osman u kthye drejt perëndimit dhe më 1574 udhëhoqi me sukses fushatën për marrjen e Tunizit të cilin e mbanin spanjollët.

Pak vite më vonë u rikthye drejt lindjes ku më 1580 udhëhoqi ushtrinë osmane kundër safavidëve të Persisë në kuadër të luftës osmano-safavide të viteve 1578-1590. Meritat e tij bënë që të emërohej Kryeministër nga Sulltan Murati III. Një vit më vonë për shkak të dështimit të zëvendësit të tij Mehmed Pasha në fushatën e Gjeorgjisë u caktua guvernator i Damaskut.

Më 1589 për të qetësuar revoltën e madhe të jeniçerëve u caktua Kryeministër për herë të dytë. Gjatë kësaj periudhe ai u përpoq të ndikojë në politikën rumune në kuadër të rivalitetit për fronin e principatës së Vllahisë mes Mihnea Turcitol dhe Petru Cercel, duke ia dalë me sukses që të vendosë në postet kyçe në shtetin vasal të Vllahisë bashkëpunorët e tij të ngushtë nga familja Bruti me origjinë nga Ulqini. Nga kjo familje, përveç Bartolomeos i cili në sajë të dashamirësisë dhe mbështetjes që kishte nga shqiptari Sinan Pasha, Kryeministër i Perandorisë, arriti të bëhej ministër i parë i principatës së Moldavisë, edhe të tjerë anëtarë arrijnë që të përfitojnë nga mbështetja e lobit shqiptar në oborrin perandorak osman duke zënë poste të larta në provincat e principatat e krishtera ballkanike që ishin vasale të Portës së Lartë.

Personazhe të tjera të

rëndësishme të kësaj familjeje në Moldavi, përmenden edhe Kristoforo, Xhakomo, Bernardo e Benedeto Bruti. Ky i fundit kishte arritur që në sajë të mbështetjes nga Sinan Pasha të ketë fuqi të tillë në këtë principatë sa që më 1593 të synojë të rivendosë në fronin moldav, Petru Cercel.

Një revoltë tjetër e jeniçerëve solli shkarkimin e tij nga posti i Kryeministrit, por pa kaluar shumë më 1593 erdhi në atë post për herë të tretë. Menjëherë udhëhoqi ushtrinë osmane në luftën me Habsburgët ku megjithë vështirësitë e frontit dhe sukseset e vazhdueshme të tij u shkarkua sërisht në shkurt të vitit 1595, si pasojë e ardhjes në fron të sulltanit të ri Mehmetit III. Por nuk vonoi dhe Sulltani i ri e thirri sërisht në ndihmë dhe e emëroi për herë të katërt sadrazam apo kryeministër të shtetit më të fuqishëm të kohës. Periudha nga emërimi i tij e deri tek shkarkimi në nëntor të po atij viti ishte e mbushur me përballjen ushtarake me principatën e Vllahisë, kundër uzurpatorit Mihal. Mirëpo, vetëm tre ditë mbas shkarkimit, u emërua sërisht për të pestën herë si sadrazam, detyrë të cilën e mbajti deri sa vdiq më 3 prill të vitit 1596.

Përveç pasurisë së madhe (e vlerësuar në rreth 500 mijë dukate ari) dhe veprave të shumta të bamirësisë, la pas edhe një sërë arritjesh e veprash që ndikuan për shumë kohë në historinë e shek. XVII osman dhe në historinë e popullit shqiptar për shekujt në vazhdim. Përveç shumë veprave të bamirësisë në Stamboll ka lënë edhe kompleksin e xhamisë që mban emrin e tij në

Damask si edhe një sërë veprash bamirësie me rëndësi në trojet shqiptare me të cilat mbajti lidhje gjatë gjithë jetës pavarësisht karrierës së tij të lavdishme dhe rolit të tij të spikatur në historinë botërore. Shquhet në këtë aspekt kompleksi i xhamisë që mban emrin e tij në Kaçanik. Qytetit i Kaçanikut ia detyron themelimin e vet, pikërisht vakëfit të lënë nga vetë Koxha Sinan Pasha në vitin 1594, ku përveç xhamisë, ka lënë vakëf edhe një pazar, shkollë për mësim-besim, dhe për shërbime përkatëse mirëmbajtëse. Vakëfnameja e lënë nga i biri Mehmet Pashë Kaçaniku më 1608 është një nga dokumentet më të rëndësishëm dhe më të hershëm osmanisht në Arkivin e Kosovës. Në këtë vakëfname i biri shkruan se po lë në vakëf krejt pasurinë e trashëguar nga im atë Sinan Pasha në Topojan së bashku me një xhami (mesxhid). Po ashtu në Prishtinë ka ndërtuar dhe lënë vakëf një kompleks hamami, ndërsa në Shkup dhjetra dyqane. Nga ana tjetër ai la vakëf dhe vepra bamirësie edhe në qytetet bregdetare si Vlorë, Delvinë dhe Ulqin, qytete me të cilat i mbante lidhjet gjatë kohës që ishte admiral i flotës osmane në Mesdhe.

Këta sundimtarë të mëdhenj të shtetit osman jo vetëm mbanin lidhjet me familjet e tyre, por ishin treguar vazhdimisht si mbështetësit dhe bamirësit më të mëdhenj të shqiptarëve që mbërrinin në kryeqytetin osman, pavarësisht fesë. Këtë e ilustron më së miri ndihma e madhe që Sinan Pasha i dha gjatë gjithë jetës vëllezërve Bruti me origjinë nga Ulqini.


Bartolomeu, njëri nga vëllezërit Bruti për shkak të intrigave të një rivali të tij në Konstantinopojë, Giovanni Marigliano, u burgos në korrik 1579. Ndëshkimi i tij pritej të ishte varja ose të dërgohej në galera si remëtar, por ndërhyrja dashamirëse e Sinan Pashës e shpëton.

Ndërkohë që Sokoloviçi tashmë e kishte denoncuar me akuzë false tek Sulltani dhe pritej varja e Brutit, Sinan Pasha hartoi me shpejtësi një arz për Sulltanin duke sqaruar se Sokoloviçi po përpiqej ta ndëshkonte Brutin sepse ai vetë ishte i përfshirë në politikë përçarëse. Por në Stamboll ekuilibrat e pushtetit kishin ndryshuar në favor të lobit shqiptar të kryesuar nga Sinan Pasha. Lobi sllav ishte shkërmoqur me vrasjen e Mehmet Sokolit më 11 tetor 1579 dhe sapo mori vesh për arrestimin e Brutit, e motra e Sinan Pashës, një rast i rrallë por i rëndësishëm ky i pushtetit të një gruaje, kishte dërguar urgjent 25 njerëz besnikë të saj drejt Lezhës për ta liruar Brutin dhe për ta kthyer në Stamboll.

Jo vetëm kaq, por Bruti i sigurtë për mbështetjen e mëtejshme të bashkëatdhetarit të tij, ofrohet si ndërmjetës tek Sinan Pasha për çështje të ndryshme. Kështu anëtarët familjes Bruti, arrijnë që të kapin majat e lavdisë pikërisht në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me shqiptarët me influencë në oborrin osman, qoftë në rolin e tyre si dragomanë (nga arabishtja: terxhyman: shqip: përkthyes) ashtu edhe si ndërmjetës të privilegjuar në lidhjet mes vendeve evropiane dhe perandorisë osmane.

Duke folur për sulmin osman kundër Korfuzit më 1537, kronisti venecian, L. Soranzo, thotë se inspirues i atij aksioni u bë Sinani, një shqiptar nga fshati Topojan i Sanxhakut të Prizrenit. Sipas Antonio Tiepolo-s, bajli në Kostandinopojë që e njohu mirë personalisht, "Veziri i Madh Sinan Pasha, ishte me kombësi shqiptare dhe kishte lindur në një fshat dy ditë larg Shkodrës. Ishte trupmadh, me një vështrim të egër që nuk dinte të zbutej kurrë. Bënte plane madhështore, që kapërcenin çdo masë. Si ushtarak, dallohej për një guxim të çartur e të papërmbytur (soldato temerario e impetuoso). Më 1590 bajliu Lorenzo Bernardo po ashtu thotë se Sinan Pasha "e qeveris sot Perandorinë Osmane, i ndihmuar nga fati dhe nga gruaja e Sulltanit, e cila është shqiptare si ai".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Krasniqi pas kritikave për fitore të pamërituar: E kam dridhur kundërshtarin në tre raundet e para



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 GUSHT - Boksieri i suksesshëm shqiptar Robin Haxhi Krasniqi u kritikua se të shtunën në mbrëmje ka shënuar fitore të pamërituar ndaj Nadjib Mohammedi në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Boksieri junikas fillimisht ka përmendur sukseset që ka në karrierën 20-vjeçare. "I kam fituar dy tituj të botës, dy tituj evropianë dhe dhjetëra tituj internacionalë, por e kuptova nga rrjetet sociale se unë nuk po e kuptoja boks fare, madje paskam ardhur në Kosovë për të më falur referi fitoren", ka thënë Krasniqi, i cili e ka kritikuar ish-boksierin Afrim Majanci për komentim, duke thënë se ka qenë skandaloz dhe tendencioz. "Sipas ekspertëve të rrjetëve sociale, individëve të caktuar, që çdo gjë bëjnë për të krijuar klikime dhe sipas komentatorëve zyrtarë që e kanë komentuar duelin tim të së shtunës, unë vërtet e paskam humbur duelin dhe fitoren ma paska dhuruar referi. Me këto dy grupet e paramete vërtetë nuk do të merrem fare, sepse është shumë në rregull nëse e kanë një pikëpamje tjetër përshkak se nuk janë profesionistë të fushës, por unë pasi e

shikova duelin me komentim, kam mbetur pa koment dhe vërtet secilin nga 'ekspertët' e rrjetëve sociale e kuptoj, meqë edhe ata e kanë dëgjuar atë komentim. Komentimi i analistit të quajtur Afrim Majanci, i cili është një ish-boksier amator i njohur në Kosovë, ishte jo vetëm skandaloz, por edhe tendencioz. Komentet e tij ndikonin edhe në komentimin e kolegut të tij, i cili, siç dukej, pak kishte lidhje me boks", ka deklaruar boksieri shqiptar. Krasniqi ka folur edhe për kundërshtarin Nadjib Mohammedi, për të cilin ka thënë se u diskualifikua shumë më vonë sesa që duhej të diskualifikohej, sepse boksi nuk është MMA. "Së pari dua ta përgëzoj kundërshtarin tim Nadjib Mohammedi për luftën e tij të përzemërt dhe për duelin e madh që ma dhuroi, sepse pa kundërshtar cilësor nuk ka duel cilësor, por ai jo vetëm që humbi me pikë, por u diskualifikua shumë më vonë sesa që u dashtë të diskualifikohej, sepse boksi nuk është MMA. Unë ose boksoj ndaj një kundërshtari cilësor, ose nuk boksoj fare, andaj qëllimi im dhe i ekipit tim ka qenë gjithmonë që të sjellim kundërshtar të nivelit të lartë botëror në Kosovë dhe këtë e kemi bërë", ka shtuar ai. "Po kthehem te

komentimi i Afrim Majancit. Ky zotëria në këtë duel asnjë goditje timen të pastër nuk e paska komentuar, madje as goditjet nga të cilat është dridhur kundërshtari në tre raundet e para nuk i paska vërejtur. Ndërkaq goditjet pas koke, goditjet me pjesën e brendshme të dorëzave dhe shumë goditje të tjera të papastra e të palejuara të kundërshtarit tim nuk i komentoi aspak. Edhe më skandalozë është se ky zotëria as qortimet dhe heqjen e pikëve të kundërshtarit nga referi nuk i kishte parë fare dhe nuk i paska komentuar. Vlerësimi i tij i vetëm paska qenë të shkuarit përpara me kokë nga ana e kundërshtarit. Nëse unë boksoja në defensivë atë e quante humbje, ndërsa ofensivën e quante prije, pa marrë parasysh se goditjet më të shumta të kundërshtarit kanë përfunduar në mbrojtjen time!", ka deklaruar Krasniqi. Robin Haxhi Krasniqi ka shprehur keqardhje që tifozët e boksit drejtpërdrejt janë keqinformuar sepse, sipas tij, zëri i komentuesit natyrisht se ndikon shumë te vlerësimi final i një teleshikuesi. Gjithashtu, ai shprehi keqardhje edhe për partnerin televiziv "TËVË1" i cili ka bërë gjithçka që transmetimi të realizohet edhe pse kushtet atmosferike sollën gati deri tek anulimi i të gjithë mbrëmjes.

SHKURT

Gjyqtarët suedezë do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjen Ballkani - Lincoln Red Imps

Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani, do të luajë në rrethin e tretë të Ligës së Konferencës përballë Lincoln Red Imps nga Gjibraltari. Dueli i parë në mes të Ballkanit dhe Lincoln Red Imps do të zhvillohet të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 20:45. UEFA ka caktuar tanimë gjyqtarët që do të ndajnë drejtësinë në këtë sfidë. Suedezi Kristoffer Karlsson është gjyqtari kryesor në këtë sfidë me ndihmësit Simon Kristensson dhe Mark Josef.

KB Trepça përforcohet me Dardan Kapitin

KB Trepça është përforcuar me basketbollistin e Përfaqësueses së Kosovës, Dardan Kapiti. 23-vjeçari në katër sezonet e fundit luajti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai së fundmi ishte pjesë e Eastern Kentucky në NCAA D1. Kapiti te kjo skuadër luajti me mesatare prej 4.5 pikëve e 2.4 kërcimeve për ndeshje. "Dardan Kapiti në Trepçë. Qendra kosovare, Dardan Kapiti, i bashkohet Trepçës nga ekipi Eastern Kentucky, liga e kolegjeve NCAA D1", thuhet në njoftimin e Trepçës.

Frosinone interesohet për Manajn

Rey Manaj pas një pauze të gjatë është duke u lidhur me një kalim te skuadra e njohur italiane Frosinone. Në fakt, "Sky Sport" raporton se ekipi i sapongjitur në Serinë A po mendon për Rey Manaj si një opsion për ta përforcuar fazën ofensive. Sulmuesi kuqezi po kalon momentin më të vështirë në karrierë pasi kalimi i tij te Watfordi, në Championship, nuk shkoi sipas parashikimeve. Frosinone përfaqëson tani një mundësi ideale për Rey Manajn për t'u rikthyer edhe një herë në vitrinën e futbollit të rëndësishëm pas një pauze të gjatë.

Hadërgjonaj kalon nga Kasimpasa Alanyaspori

Mbrojtësi Florent Hadërgjonaj është larguar nga Kasimpasa për t'u transferuar në klubin tjetër turk Alanyaspor. Mediet turke raportojnë se ky klub e mori 29-vjeçarin si lojtar të lirë pasi i kishte skaduar kontrata me klubin e deritashëm, ku luajti tri vjet. Ai kishte oferta nga Greqia, ku e pëlqenin Panathinaikos, AEK-u e Olympiacos, ndërsa në Alanya do ta gjejë lojtarin tjetër të kombëtares së Kosovës, Fidan Aliti. Mbrojtësi i djathtë kështu do të luajë edhe për një vit në Superligën turke, ndërsa në të kaluarën ishte pjesë e ekipeve Young Boys, Ingolstadt, Huddersfield dhe së fundmi në Kasimpasa. Me këtë të fundit i ka zhvilluar 112 ndeshje dhe i ka realizuar 7 gola dhe i ka bërë gjashtë asistime.

Ballkani e mëson kundërshtarin eventual të 'play-off'-it në Ligën e Konferencës

Suharekë, 7 gusht - Ballkani është skuadra e vetme nga Kosova që ka mbetur ende në garat evropiane. Ky klub e ka mësuar emrin e kundërshtarit eventual të "play-off"-it në Ligën e Konferencës. Kampionët e drejtuar nga trajneri Ilir Daja

kanë kaluar në rrethin e tretë kualifikues të kësaj gare dhe, nëse përparon tutje, në fazën e "play-off"-it do të ketë punë me fituesin e duelit në mes të Bjellorusisë dhe Sheriff Tiraspolit nga Moldavia. Por, për të kaluar në këtë përballje, ekipit portokalli së

pari i duhet ta eliminojë kundërshtarin e radhës në Ligën e Konferencës, ekipin nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps. Duetet e para të rrethit të tretë kualifikues do të luhen më 24 gusht, ndërsa ato të kthimit një javë më vonë.




Sainz 'tradhton' Ferrarin, firmos me Sauberin

Madrid, 7 gusht - Piloti Carlos Sainz mund të largohet nga Ferrari. Mediet raportojnë se piloti spanjoll ka nënshkruar një parakontratë me skuadrën Sauber, e cila mund të shënojë një kapitull të ri në karrierën sportive. Pasi do të regjistronte

një lëvizje të bujshme në botën e Formulës 1, Carlos Sainz është pjesë e skuadrës së Ferrarit, ndërkohë që kontrata me "kokëkuqen" është e vlefshme deri në vitin 2024. Në 2026-n skuadra Sauber do të shndërrohet në Audi, gjë që i

shton edhe më shumë mundësitë që të bashkohet me këtë skuadër. Drejtori i ekipit italian, Frederic Vasseur, e ka bërë të qartë se rinovimi i kontratave të pilotëve nuk është prioritet për momentin. E në të tilla kushte edhe spanjollit duket

se ka gjetur destinacionin e ri. "Duhet sa më shpejt të jem në dijeni të marrëveshjes. Do të jem më i qetë dhe më i përqendruar nëse do të jem plotësisht i bindur se me cilën skuadër do të garoj në vazhdim", ka thënë Sainz.



Sot shorti i parakualifikimeve për Kupën e Botës 2027, Kosova në vazon e dytë

PRISHTINË, 7 GUSHT - Rruga drejt FIBA Kupës së Botës 2027 do të fillojë nga raundi i parë i Parakualifikimeve Evropiane. Shorti do të hidhet në Munihi të Gjermanisë sot (e martë) dhe do të transmetohet drejtpërdrejt në kanalën e FIBA-s në YouTube nga ora 11:00. Në raundin e parë do të jenë 10 shtete pjesëmarrëse, të cilat do të ndahen në tri grupe. Grupi A do të përmbajë katër ekipe, ndërsa grupet B dhe C do të përfshijnë nga tri kombëtare. Kombëtalet do të luajnë me njëra-tjetrën në grupin e tyre në shtëpi dhe jashtë. Armenia dhe Azerbajxhani nuk mund të përfshihen në të njëjtin grup, sipas vendimit të Bordit të FIBA Europe. Raundi i parë parakualifikues i Kupës së Botës të Basketbollit FIBA 2027 do të luhet në tre ditore më 19-27 shkurt



2024, 18-26 nëntor 2024 dhe 17-25 shkurt 2025 me dy ditë lojërash në çdo ditore. Të tre fituesit e grupeve së bashku me skuadrën e renditur më të mirë në vendin e dytë do të kalojnë në raundin e dytë parakualifikues të Kupës së

Botës 2027 të FIBA-s, i cili do të luhet në verën e vitit 2025.

Vazo 1: Rumania, Zvicra, Austria
Vazo 2: Luksemburgu, Kosova, Armenia
Vazo 3: Norvegjia, Irlanda, Shqipëria
Vazo 4: Azerbajxhani

Rrahmani konfirmon largimin nga Ballkani: Faleminderit të gjithëve!

SUHAREKË, 7 GUSHT - Sulmuesi i njohur Albion Rrahmani e ka konfirmuar edhe zyrtarisht largimin nga skuadra e Ballkanit. Sukseset e sulmuesit me klubin nga Suhareka përgjatë dy vjetëve ishin të mëdha. 22-vjeçari ka falënderuar të gjithë në klub, presidentin Arsim Kabashi, trajnerin Ilir Daja, tifozët "Xhebrailat" dhe të gjithë trajnerët që ka punuar në të kaluarën. "Të dashur miq, adhures të futbollit e ju përkrahës të Klubit FC Ballkani, ju konfirmoj përfundimin e aventurës time dyvjeçare në Klubin e Futbollit FC Ballkani. Klub ky që më dha shumë e më bëri ky që jam sot, si vetë ai, kampion. Për dy vjet fituam shumëçka në futbollin vendor e bëmë historinë në arenën ndërkombëtare", ka thënë Rrahmani. "Dua t'i falënderoj të gjithë për përkrahjen dhe besimin maksimal ndaj meje, duke filluar nga kryesia, në krye me presidentin Arsim Kabashi, shtabin teknik me trajner, profesorin e nderuar dhe kampion



Ilir Daja. Të gjithë bashkëlojtarët e mi që bashkërisht u rritëm e më ndihmuam shumë gjatë këtyre dy viteve, trajnerët e mi të nderuar në të kaluarën, Nehat Kastrati, Faruk Statovci, Senad Alirifa, Arsim Thaqi, pa harruar tifozët më të mirë në vend 'Xhebrailat' dhe gjithë qytetin e mrekullueshëm të Therandës,

shtëpinë time të dytë. Ju premtoj që nuk do t'ju harroj kurrë, do t'ju bëj krenar e do t'ju kem në zemër dhe do t'ju përcjellë gjithmonë. Deri në herën tjetër, mirupafshim!", ka shtuar Rrahmani. Albion Rrahmani karrierën do ta vazhdojë në Rumani, te Rapidi i Bukureshtit.

SHKURT

Arteta: Fituam ndaj skuadrës më të mirë në botë

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, pasi skuadra e tij e mposhti Manchester Cityn në finale të Superkupës së Anglisë, ka thënë se nuk ka asgjë më të mirë se të fitosh një trofe në "Wembley" ndaj skuadrës më të mirë në botë. "Është një ndjenjë e mrekullueshme, nuk mund të ketë asgjë më të mirë se të fitosh një trofe në 'Wembley' kundër skuadrës më të mirë në botë. Sidomos mënyra se si e bëmë. Ne patëm raste të shkëlqyera në pjesën e parë, por nuk i shfrytëzuam. Nuk e dinim se si mund të kishte shkuar. Megjithatë, bëmë zgjedhjet e duhura, gjetëm një moment dhe bindje që na lejoi të barazonim fillimisht dhe më pas të fitonim në penallti. Sot treguam elasticitet dhe luftuam", ka thënë Arteta.

Guardiola pas humbjes nga Arsenalit: Tetë minuta shtesë ishin pa arsye

Manchester City e humbi finalen e Superkupës së Anglisë ndaj Arsenalit, derisa trajneri Pep Guardiola shprehu pakënaqësinë për faktin se u dhanë plot tetë minuta shtesë. "Urime për Arsenalin! Ata luajtën më mirë në 15-20 minutat e fundit të pjesës së parë, ne bëmë shumë më mirë në pjesën e dytë. Nuk më dukej se gjërat kishin ndodhur për të shtuar tetë minuta. Por kushdo që bën rregullat, nuk bën të merresh me lojtarët, me trajnerët... Tani ndeshjet do të zgjasin 100 minuta. Imagjinoni sikur të shtojnë më shumë kohë shtesë për gola e kështu me radhë... Nesër në mëngjes jemi ende këtu për të luajtur", ka deklaruar Guardiola.

Messi shënon edhe dy gola për Inter Miamin

Ylli argjentinas Lionel Messi e ka nisur furishëm sezonin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ish-asi i Barcelonës dhe PSG-së shënoi edhe dy gola të tjerë kundër FC Dallasit. Messi realizoi në minutën e gjashtë, kurse golin e dytë e shënoi në minutën e 85-të duke e barazuar në 4-4. Shtatë herë fituesi i "Topit të artë" ishte i saktë edhe nga pika e bardhë, gjatë ekzekutimit të penalltive. Kështu Inter Miami, shkon në finalen e Ligës së Kupës. Argjentinasi kështu arriti në kuotën e shtatë golave në katër ndeshje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Silva dëshiron largimin, City nuk e pranon

Pas largimit të "katalizatorit" gjerman të mesfushës Ilkay Gundogan, më pas "fantazistit" algerian Riyad Mahrez, tanimë tekniku Pep Guardiola mund të humbasë një tjetër "yll" të "qytetarëve" të tij. Bëhet fjalë për "fantazistin" portugez Bernardo Silva, për të cilin Barça fillimisht bën gati një paketë prej 50 milionë paundësh, e cila u refuzua nga "qytetarët", mirëpo negociata duket se kanë marrë një tjetër rrjedhë, më "luzitanin", i cili ia ka shprehur qartë teknikut Guardiola se dëshiron largimin nga "Etihad". Në krahun tjetër, Bernardo Silva e dëshiron një kalim te "katalanasit" aty ku do të punojë nën drejtimin e teknikut Xavi. Mirëpo, problemi kryesor lidhet me Guardiolan, pasi trajneri spanjoll nuk ka ndërmend të privohet nga shërbimet e Silvës. Një futbollist të cilin e vlerëson shumë dhe e ka jetik për skemat e tij.

Lakersat dhe Davisi nënshkruajnë kontratën 'e frikshme'

Los Angeles Lakers nuk ka humbur kohë dhe ka blinduar Anthony Davisin. Në fakt, në ditën e parë të negociatave ata kanë gjetur një marrëveshje për zgjatjen e kontratës. Sinjalet pozitive dolën më parë, si nga drejtuesit e Lakersit,

ashtu edhe nga menaxheri i lojtarit. Davisi kishte një kontratë që skadon në vitin 2025, por tani lidhja e tij me ekipin kalifornian zgjatet deri në vitin 2028. Dhe është gjithashtu kontrata më e pasur ndonjëherë në baza vjetore,

me një vlerë prej 186 milionë dollarësh (168 milionë euro) për periudhën trevjeçare nga 2025 deri në 2028, duke tejkaluar rekordin e vendosur nga Jaylen Brown i Boston Celticsit më pak se dy javë më parë, me një rinovim

pesëvjeçar për pak më pak se 61 milionë dollarë në sezon. Davisi falëkësaj marrëveshjeje do të fitojë 62 milionë dollarë në vit (56 milionë euro). Një marrëveshje që mund të interpretohet edhe si shenjë se Lakersi po përgatit

terrenin për një dorëzim stafete. LeBron, i cili do të jetë dyzet vjeç në vitin 2025, gradualisht mund t'ia lërë rolin e udhëheqësit të ekipit Davisit, i cili do të bëhej kështu imazhi i Los Angeles Lakersit.

Në përputhje me Nenin 147 të Ligjit Nr. 06/L – 016 Për Shoqëritë Tregtare (“**LSHT**”) dhe me Statutin e saj, Shoqëria Tregtare “**GreenEnergyCenter**” L.L.C. e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë dhe e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (“**ARBK**”) me numër unik të identifikimit (“**NUIT**”) 811943308, duke vepruar përmes aksionarëve të saj, sot me datën 01 Gusht 2023 nxjerr këtë:

Pursuant to article 147 of the Law No. 06/L – 016 P or Business organizations (“**LBO**”) and its Charter, the Business Organization “**GreenEnergy Center**” L.L.C. established in accordance with applicable legislation in Kosovo and registered in Kosovo Business Registration Agency (“**KBRA**”) with unique identification number (“**NUIT**”) 811943308, acting through its shareholders, today on 01 August 2023, issues the following:

NJOFTIM


PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË

- Kapitali i Shoqërisë zvogëlohet nga vlera e regjistruar prej 3,000.000.00 EUR (tre milion euro) në 2,500.00 EUR (dy mijë e pesëqind euro).
- Me zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë, nga 300,000.00 Aksione me vlerë nominale prej 10 EUR secila, Shoqëria do të ketë 250 Aksione me vlerë nominale prej 10 EUR secila.
- Të gjithë Kreditorët eventual të Shoqërisë kanë të drejtën që në periudhën kohore prej 21 (njëzet e një) ditësh kalendarike, nga dita e publikimit të këtij Njoftimi në shtypin ditor, t’i drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën zyrtare si në vijim:
 - Rr. Xhavit Ahmeti, Nr. 128 – Prishtinë
- Kjo shpallje vlen për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike.

NOTIFICATION

FOR DECREASE OF THE CAPITAL IN THE COMPANY

- The Company's capital is decreased from the registered amount of 3,000,000.00 EUR (three million euros) into 2,500.00 EUR (two thousand and five hundred euros)
- With the decrease of the Company's Capital, from 300,000.00 shares with a nominal value of 10.00 each, the Company will have 250 Shares with a nominal value of 10.00 EUR each.
- All eventual Creditors of the Company within a period of 21 (twenty one) calendar days from the day of publication of this Notice in the daily press, have the right submit in the Company a request for additional security or a request for non-decrease of the Company's Capital.
- Requests should be addressed to the Company through the regular mail at the following official address:
 - Str. Xhavit Ahmeti, No. 128 – Pristina
- This announcement is valid for a period of 30 calendar days.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Marigona Hyseni shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “Ymer Prizreni “ Prizren.

- Rina Rama shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Arif Mustafi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Rafet Islamaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Leotrim Zeqiraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Bajram Curi “ Krushe e Madhe.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ “ONIKS-1” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

